



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Priştina, 20. januara 2020. godine
Br. ref.:RK 1501/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI172/18

Parashtrues

**Arbër Kryeziu,
pronar i “Al-Petrol” Sh.p.k**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, CA. nr. 925/2018, i 16 korrikut 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arbër Kryeziu si pronar i kompanisë “Al-Petrol” Sh.p.k, me seli në fshatin Vragoli-Fushë Kosovë, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Elmaze Fazliu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [CA. nr. 925/2018] të 16 korrikut 2018, të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 102 [Parimet e përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 16 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.
8. Më 9 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzonte në Gjykatë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac. nr. 067/2017], të 19 dhjetorit 2017.
9. Më 17 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
10. Më 18 dhjetor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 13 janar 2016, A. H., F. K., S. I., A. B., T. M., S. H. dhe G. S., në cilësi të ish-punëtorëve të kompanisë “Al Petrol” Sh.p.k, në të cilën është pronar parashtruesi i kërkesës kishin parashtruar ankesë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës (në tekstin e mëtejme: TEIP), duke kërkuar që atyre t’iu bëhet kompensimi financiar për punën e bërë jashtë orarit.
12. Më 26 shkurt 2016, TEIP-ja, përmes Aktvendimit [Nr. 02/b-170/16], kishte urdhëruar parashtruesin e kërkesës që t’i eliminojë të gjitha parregullsitë në raport me palët e lartcekura, dhe për një gjë të tillë ta njoftoj TEIP.
13. Më 25 prill 2016, TEIP-ja kishte thirrur parashtruesin e kërkesës që të dëshmoj nëse i kishte zbatuar vërejtjet e dhëna në aktvendimin e lartpërmendur. Nga shkresat e lëndës rezulton se, parashtruesi i kërkesës nuk i kishte zbatuar vërejtjet e dhëna, duke pretenduar se A. H., F. K., S. I., A. B., T. M., S. H. dhe G. S. i kishin shkaktuar dëm të madh financiarë kompanisë sh.p.k. “Al Petrol” dhe se rasti i tyre tanimë ishte paraqitur në polici.
14. Më 29 prill 2016, TEIP-ja, përmes Aktvendimit [Nr. 02/b-342], i kishte shqiptuar gjobën parashtruesit të kërkesës në vlerë prej 3.500,00 € si pronar i kompanisë sh.p.k “Al-Petrol” për shkak të moszbatimit të dispozitave të nenit 38, paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe nenit 55, paragrafi 1, 2, 4, 5 dhe 6 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212. Më tutje, në Aktvendim theksohet se parashtruesi i kërkesës nuk kishte respektuar vërejtjet e Aktvendimit të TEIP-së [Nr. 02/b-170/16], të 26 shkurtit 2016.
15. Më 23 qershor 2016, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte përmbushur obligimin e tij, TEIP kishte bërë propozim për përmbarim të Aktvendimit [Nr. 02/b-342], të 29 prillit 2016, të TEIP-së.
16. Më 23 qershor 2016, Zyra e Përmbaruesit Privat S. A. në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim, kishte lëshuar Urdhrin [P. nr. 273/16] për caktimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke detyruar parashtruesin e kërkesës, që të paguaj borxhin në shumën prej 3.500,00 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.
17. Më 8 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti prapësim në Gjykatën Themelore, duke pretenduar ndër të tjera, se urdhri për përmbarim është në kundërshtim me nenet 36, par. 1, nenin 43, par. 1, neni 44, par. 1 dhe 47 par. 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, dhe rrjedhimisht i njëjti është i papërshtatshëm sepse nuk ka të bashkëngjitur Aktvendimin [Nr. 02/b-342] dhe nuk përmban klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarim. Përmes përgjigjes në këtë prapësim, kreditori kundërshtoi pretendimet e debitorit.
18. Më 9 tetor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP. nr. 589/16] aprovon prapësimin e parashtruesit të kërkesës dhe shfuqizoi urdhrin përmbarimor [P. nr. 273/16], të 23 qershorit 2016, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat S. A. Më tutje, në Aktvendim theksohet se “*kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e urdhrit për përmbarim nga ana e*

përmbaaruesit, sepse vendimi i marrë në procedurë administrative nuk ka vërtetim për përmbaarueshmëri, nuk përmbaan vulën e ekzekutueshmërisë, në kuptim të nenit 36, par 1 të LPP-së, andaj për këtë arsye gjykata e aprovoi prapësimin e debitorit dhe e shfuqizoi urdhrin e përmbaaruesit privat [...]”.

19. Më 3 nëntor 2017, TEIP në cilësi të kreditorit, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP. nr. 589/16], të 9 tetorit 2017, duke pretenduar se vendimet e TEIP-së, janë të ekzekutueshme dhe se ankesa kundër tyre nuk e ndalë ekzekutimin.
20. Më 19 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit të Kosovës, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 5067/2017] aprovoi ankesën e TEIP-së, dhe e ktheu rastin në Gjykatën Themelore në rigjykim, duke arsyetuar se *“vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje të dispozitës së nenit 38, par. të LPP-së lidhur me nenin 102, par. 1 të LPK-së, për shkak se gjykata e shkallës së parë para se të vendoste lidhur me prapësimin e debitorit, ka pasur detyrim ligjor që ta ftoj kreditorin që brenda afatit ligjor prej 3 ditësh, gjykatës t’ia prezantojë origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit përmbaarimor dhe të pajisur me klauzolën e përmbaarueshmërisë, duke e njoftuar qartë kreditorin edhe për lëshimet procedurale në rast se nuk vepron sipas urdhrin të gjykatës, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 102.3 të LPK-së”*.
21. Më 26 janar 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar në rigjykim përmes Aktvendimit [PPP. nr. 62/18] e refuzoi të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbaarimit P. nr. 273/16, të 23 qershorit 2016. Më tutje, në këtë Aktvendim theksohet se *“Gjykata vlerëson se lejimi i përmbaarimit në rastin konkret është i bazuar në dispozitën e nenit 27 dhe 36 të LPP-së, ngase Aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në Gjilan, Nr. 02/b-3 42 të dt.29.04.20 16, është i përshtatshëm për përmbaarim, origjinal, është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm me dt. 03.06.2016, përmbaan vulën me të cilën vërtetohet se "ky vendim është ekzekutiv", pra përmbaan klauzolën e përmbaarueshmërisë për përmbaarueshmëri, nga çka rezulton se është përmbaarimor. Prandaj gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga shkaqet për prapësim që përcakton dispozita e nenit 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbaarimit*.
22. Më 8 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PPP. nr. 62/18] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 26 janarit 2018, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave ligjore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës materiale.
23. Më 16 korrik 2018, Gjykata e Apelit të Kosovës, përmes Aktvendimit [CA. nr. 925/2018] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [PPP. nr. 62/18] e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 26 janarit 2018, duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm.
24. Më 9 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Prokurorisë së Shtetit me kërkesë për ushtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit [CA. nr. 925/2018] të Gjykatës së Apelit, të 16 korrikut 2018.

25. Më 3 shtator 2018, Prokuroria e Shtetit përmes Njoftimit KMLC. nr. 120/2018, njoftoi parashtruesin e kërkesës se propozimi nuk është aprovuar sepse nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për një gjë të tillë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 102 [Parimet e përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
27. Lidhur me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Themelore në Prishtinë, e njëjta gjyqtare e cila njëherë e ka aprovuar kundërshtimin e debitorit me Aktvendimin PPP.nr.589/l6 me dt.09.10.2017, vendos lidhur me ankesën e kreditorit MPMS, pa e përcjellur lëndën me ankesë në Gjykatën e Apelit, merr Aktvendim PPP.nr.62/l8 të dt.26.01.2018 që kundërshtimin të cilin e kishte aprovuar më parë ta refuzoj si të pabazuar me arsyetim se aktvendimi administrativ që kërkohet të përmbarohet është i përshtatshëm për përmbarim, përmban klauzolën e përmbarueshmërisë”*.
28. Parashtruesi i kërkesës më tutje thekson se *“Aktvendimi i Inspektoratit të Punës nuk mund të konsiderohet akt administrativ, sepse i njëjti nuk i përbën elementet e ushtrimit të pushtetit publik që këto elemente janë të domosdoshme për t’u konsideruar një akt si akt administrativ. Prandaj si i këtillë nuk ka mundur të përmbarohet sipas LPP-së. Gjykata përmbarimore në mënyrë kundërkushtetuese i ka marrë kompetencat e organeve tjera, dhe ka vendosur të përmbarohet aktvendimi i cili edhe nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë e as të ekzekutueshmërisë. Me një veprim të tillë të gjykatave të rregullta është cenuar rëndë neni 31, par. 1 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, sipas të cilit është përcaktuar se “çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.
29. Lidhur me nenin 102 [Parimet e përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Aktvendimi i Inspektoratit të Punës për gjobitje është marrë pa i dhënë mundësin Kompanisë "Al-Petrol" Sh.p.k që të sqarohet lidhur me faktet kontestuese, nga se një çështje e tillë nuk mund të vendoset pa u dëgjuar të dyja palët, se kjo është një çështje kontestimore e cila duhet të vendoset në gjykatë, e jo nga Inspektorati i Punës, që në këtë rast është cenuar rëndë edhe neni 102 par. 1 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se “Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat*.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshme Aktvendimin PPP. nr. 62/18 i Gjykatës Themelore, i 26 janarit 2018 dhe Aktvendimi CA. nr. 925/2018, i Gjykatës së Apelit, i 16 korrikut 2018”.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

34. Fillimisht, Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës (si person juridik) ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, par.14).

35. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi ngrit dy lloje të pretendimeve kushtetuese lidhur me rastin e tij.

36. Prandaj, Gjykata gjatë shqyrtimit të mëtejme nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, do t'i trajtojë këto dy pretendime ndaras.

(i) Lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës

37. Fillimisht, Gjykata rikujton pretendimin e parashtruesit lidhur me faktin se e njëjta gjyqtare ka vendosur dy herë lidhur me rastin e tij, së pari duke e aprovuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës dhe pastaj pas ankesës së TEIP e njëjta gjyqtare duke vepruar në rigjykim, kishte refuzuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës.

38. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, gjithashtu përcakton detyrimin e shterimit të *“të gjitha mjeteve juridike të*

përcaktuara me ligj”. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Këto të fundit përcaktojnë:

*Neni 47
[Kërkesa individuale]*

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

*Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]*

“(1). Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

“(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”.

39. Gjykata pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, vëren se parashtuesi për herë të parë ngrit pretendimin e lartpërmendur para Gjykatës.
40. Gjykata thekson se parashtuesi duhet të ketë paraqitur këtë pretendim në ankesën e tij në Gjykatën e Apelit, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Megjithatë ai nuk e kishte paraqitur.
41. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta duhet t'u jepet mundësia që përfundimisht të vendosin për çështjen që është duke u shqyrtuar nga ato. Kjo do të thotë që një shkelje e pretenduar kushtetuese në përgjithësi nuk duhet të lejohet të arrijë në Gjykatën Kushtetuese, pa u shqyrtuar më parë nga gjykatat e rregullta.
42. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi 2 i nenit 47 të Ligjit dhe pika (b) e paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, ndër të tjera, qartë përcaktojnë detyrimin e *“shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj”*, në të dy aspektet, atë formal dhe substancial, me kusht që një kërkesë të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.
43. Kriteret e vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur, janë mirë të përcaktuara në praktikën e Gjykatës dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
44. Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e

përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “*substancë*” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës i kanë shfrytëzuar ato në të dy kuptimet, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi (Shih rastet e Gjykatës KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafit 57; KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 94).

45. Aspekti substancial i shterimit të mjeteve juridike është i përcaktuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe nënkupton që pretendimet për shkelje të KEDNJ-së, duhet të jenë ngritur “*të paktën në substancë*” para gjykatave të rregullta në mënyrë që të njëjtave iu janë dhënë mundësitë për të adresuar pretendimet për shkelje përkatëse. Në këtë kontekst, GJEDNJ për më tepër thekson se pretendimet për shkelje të KEDNJ-së duhet të jenë ngritur të paktën në mënyrë përmbajtësore/substanciale para gjykatave të rregullta, në mënyrë që mjetet juridike të konsiderohen të shteruara. Për më tepër që, sipas GJEDNJ-së, parashtruesit përkatës nuk mund të lirohen nga ky detyrim, edhe nëse gjykatat e rregullta mund të kenë qenë të detyruara të shqyrtojnë vet pretendimet përkatëse. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të njëjtin qëndrim e mban edhe Gjykata sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.
46. Si rezultat, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse përtej shterimit të mjeteve juridike në aspektin formal e që është rasti në rrethanat e rastit konkret, janë shteruar mjetet juridike edhe në kuptim substancial, përkatësisht nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të paktën në substancë, janë ngritur edhe para gjykatave të rregullta.
47. Gjykata rikujton edhe një herë se fillimisht se pas paraqitjes së prapësimit nga ana e parashtruesit të kërkesës kundër urdhrit përmbarimorë [P. nr. 273/16], Gjykata Themelore kishte aprovuar prapësimin e parashtruesit. Më pas, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, TEIP kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, ankesë kjo e cila ishte pranuar dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim. Më tej, Gjykata vëren se Gjykata Themelore (e njëjta gjyqtare e cila një herë kishte vendosur për prapësimin) duke vendosur në rigjykim refuzon prapësimin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
48. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave ligjore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës materiale, megjithatë, asnjëra prej tyre nuk ngrit as formalisht dhe as në substancë çështjet që ndërliohen me pjesëmarrjen e të njëjtit gjyqtar në të njëjtën instancë, dhe për më tepër për marrjen e vendimeve të ndryshme për të njëjtin rast.
49. Marrë parasysh rrethanat në të cilat sipas shkresave të lëndës rezulton se ky pretendim specifik i parashtruesit të kërkesës është ngritur për herë të parë para

Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk u ka dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, në mënyrë specifike Gjykatën e Apelit, të adresojnë këto pretendime dhe me këtë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; dhe rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74).

50. Përveç kësaj, GJEDNJ mban qëndrimin se mjete juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72).
51. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës dhe që ka të bëjë me faktin se e njëjta gjyqtare ka vendosur dy herë për rastin e tij duhet të refuzohet si e papranueshme në baza procedurale për shkak të mos shterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

(ii) *Lidhur me pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës*

52. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata përtej paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 47, 48 dhe 49 të Ligjit, e të cituara më lart, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 2 të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës, dhe i cili përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e Pranueshmërisë]

“2. Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

53. Në shqyrtimin e pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, respektivisht neni 31 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se “aktvendimi i Inspektoratit të Punës nuk mund të konsiderohet akt administrativ, sepse i njëjti nuk i përbën elementet e ushtrimit të pushtetit publik që këto elemente janë të domosdoshme për t’u konsideruar një akt si akt

administrativ. Prandaj si i këtillë nuk ka mundur të përmbahet sipas LPP-së. Gjykata përmbare në mënyrë kundërkushtetuese i ka marrë kompetencat e organeve tjera, dhe ka vendosur të përmbahet aktvendimi i cili edhe nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë e as të ekzekutueshmërisë. Me një veprim të tillë të gjykatave të rregullta është cenuar rëndë neni 31 par. 1 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, sipas të cilit është përcaktuar se “çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

54. Gjykata vëren se, esenca e pretendimeve të parashtruesit ka të bëjë me konstatim të gabuar të gjendjes faktike nga ana e Gjykatës së Apelit.
55. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, të njëjtat pretendime i ka paraqitur edhe në ankesën e tij në Gjykatën e Apelit.
56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Aktvendimi CA. nr. 925/2018, i Gjykatës së Apelit, përmes të cilit ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës adresoi dhe vendosi për pretendimet e lartpërmendura, të cilat tashmë ishin ngritur nga parashtruesi i kërkesës.
57. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit të lartpërmendur, i cili arsyetoi se *“Debitori me asnjë provë shkresore nuk ka dëshmuar se prapësimi i tij bazohet në ndonjërin nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së. Gjykata e shkallës së dytë, konstaton se Gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës përmbare drejtë dhe plotësisht ka zbatuar ligjin procedural në këtë çështje përmbare, sepse dokumenti në bazë të së cilit përmbareu privat ka lejuar përmbareimin në këtë çështje përmbare është dokument përmbareu i cili përmbush kërkesat ligjore të neneve 22 par 1.2, 23, 24 dhe 27 lidhur me nenet 36 e 38 të LPP, sepse ai është i përmbareushëm i përshtatshëm për përmbareim, është origjinal dhe i pajisur me klauzolën e përmbareushmërisë dhe formës së prerë.*
58. Gjykata konsideron se, në bazë të fakteve të këtij rasti, të cilat rrjedhin nga dokumentet e prezantuara dhe nga pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e vet, duke përfshirë edhe arsyet mbi të cilat e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore.
59. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave në gjykatat e rregullta, duke kontestuar vlerësimin e provave dhe vërtetimin e fakteve nga ana e këtyre gjykatave.
60. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33.

61. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
62. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
63. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e standardeve kushtetuese gjatë procedurave gjyqësore në gjykatat e rregullta prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37).
64. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë (Shih rastin e Gjykatës nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 majit 2012, paragrafi 28).
65. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat e njeriut nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për “gëzimin e të drejtave dhe lirive” që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, këto nene në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohen nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me “gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut” (shih, *inter alia*, *E.B. kundër Francës* [GC], par. 47, Aktgjykimi i 22 janarit 2008; *Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë*, par. 72, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 7 shtatorit 2013; gjithashtu rastin KI 67/16, parashtrues i kërkesës *Lumturije Voca*, Aktvendimi për Papranueshmëri, i 23 janarit 2017, par. 128)
66. Rrjedhimisht, në këtë pikë kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

67. Lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se në pajtim me rregullin 39 (1) (b) kërkesa duhet të shpallet e papranueshme për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike.
68. Lidhur me pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) dhe (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 18 dhjetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ijazi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

